



UNIVERSITETI KATOLIK
ZOJA E KËSHILLIT TË MIRË

RREGULLORE
e Universitetit Katolik
“Zoja e Këshillit të Mirë”

Miratuar nga Senati Akademik më datë 13.04.2023

Universiteti Katolik “Zoja e Këshillit të Mirë” (referuar në vijim si UniKZKM) është një institucion i lartë jo publik dhe jo fitimprurës i hapur me Vendim të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë nr. 567, datë 27/08/2004, fillimisht me emërtesën “Shkolla e Lartë Universitare jo publike “Zoja e Këshillit të Mirë”.

Ai është krijuar nga Fondacioni *Zoja e Këshillit të Mirë* (referuar në vijim si Fondacioni ZKM), i njohur si person juridik me Vendimin nr. 8, datë 24/11/1993 të Gjykatës së Tiranës. Emërtimin aktual Universiteti e mori në vitin 2011 me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 670, datë 28/09/2011.

KREU I - DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

- Neni 1 – Objekti
- Neni 2 – Baza ligjore
- Neni 3 – Fusha e veprimit
- Neni 4 - Rregulloret e brendshme
- Neni 5 – Rregulloret të veçanta
- Neni 6 – Njoftimet e akteve

KREU II - STRUKTURAT

- Neni 7 – Njësitë Kryesore
- Neni 8 - Qendra Studimore Ndërdisciplinore
- Neni 9 - Struktura të tjera
- Neni 10 - Hapja, riorganizimi dhe mbyllja e njësive përbërëse të Universitetit KZKM

KREU III - ORGANIZIMI AKADEMIK DHE ADMINISTRATIV

- Neni 11 – Organet dhe autoritetet akademike
- Neni 12 – Senati Akademik
- Neni 13 – Rektori
- Neni 14 – Zëvendësrektori
- Neni 15 – Sekretari i Përgjithshëm
- Neni 16 – Dekani (Drejtuesi i Njesisë kryesore)
- Neni 17 – Zëvendësdekani (Zëvendësdrejtuesi i Njesisë Kryesore)
- Neni 18 – Drejtuesi i Njesisë Bazë
- Neni 19 – Rektorati
- Neni 20 – Asambleja e Personelit Akademik
- Neni 21 – Komisionet e përhershme
- Neni 22 – Dispozita për Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë
- Neni 23 – Dekanati
- Neni 24 – Departamenti
- Neni 25 – Qendra kërkimore – shkencore
- Neni 26 – Studentët dhe Organizimi i Studimeve
- Neni 27 – Organet dhe autoritetet administrative drejtuese
- Neni 28 – Bordi i Administrimit
- Neni 29 – Administratori i Universitetit
- Neni 30 – Administratori i Fakultetit (Njesisë Kryesore)

KREU IV - PERSONELI I UNIVERSITETIT

- Neni 31 – Personeli akademik
- Neni 32 – Personeli ndihmës akademik
- Neni 33 – Masat disiplinore
- Neni 34 – Procedura për dhënien e masave disiplinore

KREU V - KËRKIMI SHKENCOR

- Neni 35 – Veprimtaritë e Kërkimit Shkencor
- Neni 36 – Projektet shkencore
- Neni 37 – Etika në Kërkimin Shkencor

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti

Kjo Rregullore ka për qëllim rregullimin e veprimtarisë mësimore-shkencore dhe administrative të Universitetit Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë" në përputhje me misionin, parimet themelore dhe fushën e veprimtarisë të përcaktuara në Statutin e tij.

Neni 2
Baza ligjore

Kjo Rregullore mbështetet në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, Ligjin nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" (më poshtë Ligji për Arsimin e Lartë), në Statutin e Universitetit, Kodin e Punës dhe aktet ligjore e nënligjore në fuqi, në marrëveshjet kombëtare dhe ndërkombëtare që kanë efekte mbi veprimtarinë e Universitetit.

Neni 3
Fusha e veprimit

Kjo Rregullore shtrin efektet e saj në të gjitha strukturat, organet dhe autoritetet drejtuese, njësitë përbërëse, personelin akademik/joakademik dhe studentët, si dhe çdo personi tjetër fizik apo juridik që vepron në objektet apo territorin e UniKZKM-së.

Neni 4
Rregulloret e brendshme

1. Rregulloret e brendshme shtrijnë efektet e tyre në të gjitha strukturat, organet dhe autoritetet drejtuese, personelin akademik/joakademik dhe studentët, si dhe çdo personi fizik apo juridik që vepron në objektet dhe territorin përkatës.
2. Rregulloret e brendshme të njërive kryesore hartohen nga asambleja e personelit akademik përkatës të tyre dhe miratohen nga Senati Akademik.
3. Rregulloret e brendshme të njërive bazë propozohen nga asambleja e personelit akademik të njësisë bazë, miratohen paraprakisht nga Dekanati dhe i përcillen Senatit Akademik për miratim përfundimtar.
4. Rregulloret e brendshme të strukturave ndihmës akademike me karakter administrativ që janë në varësi të Rektorit propozohen nga njësitë përkatëse dhe miratohen paraprakisht nga Rektori i cili ja përcjell për miratim përfundimtar Senatit Akademik.
5. Rregulloret e brendshme të strukturave administrative që janë në varësi të Administratorit të institucionit propozohen nga njësitë përkatëse dhe miratohen paraprakisht nga Administratori i cili ja përcjell për miratim përfundimtar Senatit Akademik.
6. Rregulloret e funksionimit të Komisionit të Promovimit të Personelit Akademik, Këshillit të Etikës dhe të komisioneve të tjera të përhershme në nivel institucional, hartohen nga vetë ato dhe miratohen nga Senati Akademik.
7. Rregullorja e Bordit të Administrimit të Universitetit, hartohet dhe miratohet nga Këshilli i Administrimit i Fondacionit ZKM.

Neni 5

Rregulloret të veçanta

Organet dhe autoritetet drejtuese të UniKZKM, për të siguruar zbatimin e ligjit për arsimin e lartë, të Statutit dhe të kësaj Rregulloreje ose kur ka detyrim ligjor të posaçëm, mund të hartojnë dhe të miratojnë rregullore të veçanta, të përhershme apo të përkohshme, në drejtime dhe fusha të veçanta, në situata apo kushte të një rëndësie të veçantë apo të jashtëzakonshme.

Neni 6

Njoftimet e akteve

1. Organet dhe autoritetet drejtuese, njësitë përbërëse dhe i gjithë personeli i UniKZKM informohen nga Rektorati i UniKZKM për aktet ligjore e nënligjore, apo aktet e tjera në zbatim të tyre të nxjerra nga strukturat përkatëse në zbatim të tyre.
2. Për të siguruar informimin e tyre, aktet e mësipërme publikohen në rrugë elektronike në faqen zyrtare elektronike të UniKZKM ose në Portalin e Universitetit në 3 rubrika të veçanta:
 - a) E para, rezervuar akteve zyrtare të Këshillit të Ministrave dhe Ministrisë përgjegjëse për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor, të publikuara në Fletoren Zyrtare nga Qendra e Botimeve Zyrtare, si dhe akteve të agjencive shtetërore që veprojnë në fushën e arsimit të lartë e kërkimit shkencor;
 - b) E dyta, rezervuar akteve normative të brendshme që rregullojnë veprimtarinë e Universitetit KZKM dhe të njësive e strukturave përbërëse të tij;
 - c) E treta, rezervuar akteve që përbëjnë vendimarrjen e të gjitha organeve dhe autoriteteve drejtuese të tij (Vendime të Bordit të Administrimit, Vendime të Senatit Akademik, Vendime të Rektorit ose Rektoratit, të Këshillit të Etikës, të Dekaneve ose Dekanateve të Njësive kryesore etj).
3. Aktet e pikave b) dhe c) janë të disponueshme dhe të aksesueshme vetëm për organet dhe autoritetet drejtuese, strukturat e Universitetit UniKZKM dhe për personelin akademik dhe ndihmës akademik nëpërmjet Portalit të Universitetit KZKM.
4. Strukturat dhe personeli i ngarkuar për hedhjen e informacionit të mësipërm në faqen zyrtare të Universitetit KZM dhe në Portalin e tij përcaktohen me Vendim të Rektoratit.
5. Të gjitha aktet e reja ligjore e nënligjore për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor, ndryshimet/shtesat në ato ekzistuese apo aktet e reja në zbatim të tyre, përveç se publikohen në një hapësirë elektronike përkatëse, u dërgohen organeve drejtuese dhe autoriteteve, strukturave përbërëse dhe personelit akademik, ndihmësakademik dhe administrativ të UniKZKM në rrugë elektronike në momentin e publikimit ose komunikimit zyrtar të tyre.
6. Ndryshimi apo shfuqizimi i akteve të UniKZKM bëhet me komunikim elektronik të përgjithshëm. Aktet e reja të brendshme të UniKZKM ose ndryshimi i atyre ekzistuese në lidhje me strukturat përbërëse të Universitetit dhe funksionimin e tyre, u komunikohen në rrugë elektronike të gjitha strukturave që preken dhe ndërveprojnë me të, si dhe personelit akademik e ndihmësakademik të tyre.

KREU II

STRUKTURAT

Neni 7

Njësitë Kryesore

1. Në përbërje të Universitetit KZKM janë 4 njësi kryesore të përbëra nga 3 njësi bazë secila si vijon:

Fakulteti i Mjekësisë

- *Departamenti i Shkencave Biomjekësore*
- *Departamenti i Shkencave Kirurgjikale*
- *Departamenti i Shkencave Mjekësore, në përbërje të së cilit është edhe Dega e Elbasanit*
- *Strukturat ndihmës akademike me karakter mësimor në varësi të këtij Fakulteti janë 4 laboratore (Laboratori i Mikroskopisë, Laboratori i Anatomisë, Laboratori i Simulimit në Odontoiatri dhe Laboratori i Simulimit në Shkencat Mjekësore).*

Fakulteti i Farmacisë

- *Departamenti i Shkencave Farmaceutike*
- *Departamenti i Teknologjive Kimiko - Farmaceutike dhe Biomolekulare*
- *Departamenti i Vlerësimit Kimik-Toksikologjik dhe Farmakologjik të Barnave*
- *Strukturat ndihmës akademike me karakter mësimor në varësi të këtij Fakulteti janë 2 laboratore (Laboratori Kimik dhe Laboratori Farmaceutik)*
- *Strukturë akademike me funksion kërkimor shkencor në varësi të këtij Fakulteti është Laboratori i Virologjisë.*

Fakulteti i Shkencave Ekonomike, Politike dhe Sociale

- *Departamenti i Shkencave Ekonomike dhe Sipërmarrjeve*
- *Departamenti i Strategjive Bioekonomike në BE dhe Ballkan*
- *Qendra e Studimeve mbi Ekonominë e Vendeve në Tranzicion*

Fakulteti i Shkencave të Aplikuara

- *Departamenti i Arkitekturës*
- *Departamenti i Shkencave dhe Teknikave të Arkitekturës*
- *Qendra e Kërkimeve për Arkitekturën Mesdhetare*

Neni 8

Qendra Studimore Ndërdisciplinore

Në përbërje të Universitetit janë dhe 3 Qendra Studimore Ndërdisciplinore:

- *Qendra Ndërkombetare e Kërkimeve dhe Studimeve (CIRS) në përbërje të së cilës është Observatori i Sistemeve Shëndetësore të Rajonit të Ballkanit (OSSAB);*
- *Qendra Europiane e Shkencës së Paqes, Integritit e Kooperimit (CESPIC);*
- *Qendra e Kërkimeve në Shkencat Humane (CRISU);*

Neni 9

Struktura të tjera

1. Struktura të tjera të Universitetit, janë:
 - *Qendra e Formimit të Deputeteve të Evropës Juglindore*
 - *Qendra e Gjuhëve të Huaja*
 - *Zyra e Informimit European*
2. *Strukturat akademike, ndihmësakademike me karakter mësimor dhe strukturat ndihmës akademike me karakter administrativ në nivel institucional janë në varësi të Rektorit të UniKZKM. Rektori, nga ana e tij, koordinohet dhe varet nga Bordi i Administrimit i Universitetit dhe i Fondacionit.*
3. *Strukturat akademike, ndihmësakademike me karakter mësimor dhe ndihmësakademike me karakter administrativ në nivel njësie kryesore, kanë varësi funksionale nga Dekani i njësisë kryesore përkatëse.*
4. *Struktura ndihmës akademike me karakter administrativ, të cilat funksionojnë në nivel Rektorati dhe varen direkt nga Rektori, janë:*

- a) Zyra e Vlerësimit të Cilësisë dhe Kurrikulave
- b) Zyra e Projekteve Kërkimore dhe Formuese
- c) Zyra e Statistikës
- d) Zyra e Këshillimit të Karrierës
- e) Zyra e Pranimeve
- f) Sekretaria Mësimore
- g) Zyra e Burimeve Njerëzore
- h) Zyra e Teknologjive të Informacionit
- i) Zyra Juridike
- j) Zyra Marrëdhënies me Publikun dhe Promovimit
- k) Biblioteka

5. Struktura administrative në nivel institucional janë:

- a) Zyra e Financës
- b) Zyra e Prokurimeve
- c) Zyra e Logjistikës
- d) Zyra e Design
- e) Qendra Universitare e Gjuhëve
- f) Mensa Universitare

Ato janë në varësi të Administratorit të UniKZKM.

6. Zyra Juridike, Zyra e Burimeve Njerëzore dhe Zyra e Teknologjisë së Informacionit ushtrojnë veprimtarinë e tyre në funksion të të gjitha strukturave në institucion dhe varen nga Rektori.

Neni 10

Hapja, riorganizimi dhe mbyllja e njësive përbërëse të Universitetit KZKM

1. Formulimi i propozimeve për hapjen, riorganizimin apo mbylljen e një njësie përbërëse të UniKZKM bëhet nga një komision *ad hoc* i cili:
 - a) në rastin e hapjes, riorganizimit apo mbylljes së një njësie kryesore të UniKZKM, përbëhet nga Rektori;
 - b) në rastin e hapjes, riorganizimit, mbylljes së një njësie bazë apo bashkimit të tyre në përbërje të njësisë kryesore, përbëhet nga Dekanati dhe një përfaqësues i Rektorit;
 - c) në rastin e hapjes së degëve të reja të UniKZKM, komisioni përbëhet nga Rektori;
 - d) në rastin e hapjes së degëve të njësive kryesore, Komisioni përbëhet nga Dekanati i asaj njësie dhe një përfaqësues i caktuar nga Rektori.
 - e) në rastin e hapjes së njësive bazë (departamenteve apo qendrave studimore ndërdisiplinore nga njësi kryesore të ndryshme), përbëhet nga:
 - dy përfaqësues nga secila njësi kryesore, të propozuar respektivisht nga Dekani dhe të emëruar me vendim të dekanateve përkatëse;
 - një përfaqësues i Rektorit.
2. Propozimi për hapje, riorganizim, ndarje apo mbyllje të njësive, duhet të përmbajë të dhënat e mëposhtme:
 - a) Arsyetim i argumentuar i nevojës për ndryshim;
 - b) Përshkrimin e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, që do të realizohet sipas këtij ndryshimi;
 - c) Kurrikulat për lëndët që do jepen;
 - d) Përshkrimet e punës dhe kërkesat specifike për çdo pozicion pune të ri, të krijuar apo të prekur nga propozimi;
 - e) Efektet financiare të ndryshimeve të kërkuara - përgatitur nga zyra përkatëse;

- f) Analizën sasiore për burimet e nevojshme për kryerjen e funksioneve të caktuara;
 - g) Raport për pasojat që mund të ketë ristrukturimi mbi personelin akademik, ndihmësakademik dhe administrativ të njësive dhe shpenzimet e personelit, si dhe një parashikim për sistemimin e personelit, pozicionet e të cilëve preken, si pasojë e ndryshimeve të propozuara.
3. Propozimi i hartuar i përcillet për miratim Senatit Akademik dhe më pas i trasmetohet për vendimmarrje Bordit të Administrimit.
 4. Vendimi i Bordit të Administrimit është pjesë e dokumentacionit të detyrueshëm për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e njësive përbërëse të UniKZKM.

KREU III

ORGANIZIMI AKADEMIK DHE ADMINISTRATIV

Neni 11

Organet dhe autoritetet akademike

1. Organet drejtuese të UniKZKM-së ndahen, në organe akademike, në organe administrative dhe në organe kolegjinale, siç parashikohet nga Statuti.
2. Organi drejtues më i lartë akademik i UniKZKM-së është Senati Akademik (S.A.). Kompetencat dhe përbërja përcaktohen nga Statuti i universitetit, në përputhje me ligjet aktuale.
3. Organe të tjera drejtuese akademike janë Asambleja e Personelit akademik dhe Komisionet e përhershme në nivel institucional dhe njësie kryesore.
4. Autoritetet akademike janë: Rektori, Drejtuesi i Njësisisë kryesore (Dekani i Fakultetit) dhe Drejtuesi i Njësisisë bazë (Drejtuesi i Departamentit ose i Qendrës kërkimore-shkencore). Me propozim të Rektorit, mund të krijohen gjithashtu organe të tjera institucionale, të cilave u caktohen detyra specifike.
5. Organe kolegjinale janë: Rektorati, Dekanati, Këshilli i Etikës.
6. Organet kolegjinale të UniKZKM-së thirren nga Kryetari i tyre, i cili gjithashtu përcakton rendin e ditës për mbledhjen, koordinon punën dhe siguron informacionet e nevojshme për vendimet që do të merren për secilën pikë të rendit të ditës. Kryetari është i detyruar ta thërrasë organin pas kërkesës me shkrim të së paku një të tretës së anëtarëve të tij.
7. Mbledhjet e organeve drejtuese dhe të atyre kolegjinale konsiderohen të vlefshme me praninë e shumicës së anëtarëve në detyrë. Vendimet merren me shumicën e votave të personave të pranishëm. Në rast barazie votash, mbizotëron vota e Kryetarit.
8. Përveç rasteve kur parashikohet ndryshe, mandati i anëtarëve të organeve kolegjinale, i autoriteteve akademike dhe administrative dhe i autoriteteve të tjera drejtuese, zgjat katër vjet dhe është i rinovueshëm. Pavarësisht nga kjo, mandati i autoriteteve ose i anëtarëve të organeve drejtuese dhe të atyre kolegjinale mbaron para kohe:
 - a) në rastin e dorëheqjes vullnetare ose të ndonjë pengese të përhershme për ushtrimin e detyrës;
 - b) si rezultat i ndërprerjes ose i ndryshimit të marrëdhënies akademike të studimit ose të punës me UniKZKM-në, gjë që i bën të pavlefshme kriteret që kërkohen për ushtrimin e kësaj detyre;
 - c) pas mungesës së tretë të pajustificuar në një mbledhje të thirrur në mënyrë të rregullt;
 - d) për shkelje të rëndë ose të përsëritur të ligjeve të sistemit universitar, të Statutit, të Rregulloreve, të Kodit të Etikës dhe të dispozitave të tjera të UniKZKM-së;
 - e) për shkak të arrestimit në flagrancë për vepra penale për të cilat Ligji parashikon një dënim me burgim jo më pak se dy vjet, si dhe për dënimet penale të formës së prerë që parashikojnë një burgim total prej jo më pak se gjashtë muaj;

9. Në rast të ndërprerjes së parakohshme të detyrës, mandati i subjektit të caktuar për të ushtruar këtë detyrë, do të zgjasë po aq sa periudha e mbetur deri në skadimin e parashikuar për mandatin e subjektit të zëvendësuar, përveç rastit kur përcaktohet ndryshe nga Enti përgjegjës.

Neni 12
Senati Akademik

1. Senati Akademik është organi drejtues më i lartë akademik i UniKZKM-së.
2. Kompetencat, përbërja dhe mënyrat e funksionimit të Senatit përcaktohen në ligjin e arsimit të lartë dhe në Statutin.

Neni 13
Rektori

1. Rektori është autoriteti më i lartë akademik i cili, sipas Ligjit, përfaqëson UniKZKM-në për çështjet akademike dhe protokollare.
2. Emërimi, i cili bëhet nga Bordi i Administrimit si dhe modalitetet janë të përcaktuara në Statutin e Universitetit (Neni 15).
3. Ai thërret dhe drejton Senatin Akademik dhe mbledhjen e Rektoratit për të diskutuar mbi çështjet në kompetencë dhe zgjidhjen e tyre.
4. Detyrat dhe përgjegjësitë e Rektorit përcaktohen në ligjin për arsimin e lartë dhe në Statut (Neni 15).

Neni 14
Zëvendësrektori

1. Zëvendësrektori ushtron detyrat që i janë besuar nga Rektori. Në rast mungese ose pamundësie të përkohshme të këtij të fundit, ai kryen funksionet si zëvendës i tij, duke nënshkruar aktet në kompetencë të Rektorit, me përjashtim të atyre që, sipas ligjit ose nga natyra e tyre, janë kompetenca ekskluzive dhe nuk mund të delegohen nga Rektori.
2. Modalitetet e emërimit dhe shkarkimit si dhe kompetencat dhe funksionet e tij janë të përcaktuara në Statutin e Universitetit.

Neni 15
Sekretari i Përgjithshëm

1. Me propozim të Rektorit, Fondacioni ZKM mund të emërojë, si autoritet tjetër drejtues, një Sekretar të Përgjithshëm, i cili është një personalitet i botës akademike, ose i njohur për vlerat dhe kualifikimin shkencor, mësimor dhe organizativ.
2. Modalitetet e emërimit dhe shkarkimit si dhe kompetencat dhe funksionet e tij janë të përcaktuara në Statutin e Universitetit.

Neni 16
Dekani (Drejtuesi i Njesisë kryesore)

1. Dekani (Drejtuesi i Njesisë kryesore), është autoriteti më i lartë akademik i Fakultetit.
2. Ai koordinon veprimtarinë e njësive bazë dhe organeve kolegjiale.
3. Modalitete e emërimit dhe shkarkimit të tij si dhe kompetencat dhe detyrat e tij janë të përcaktuara në Statutin e Universitetit.

Neni 17
Zëvendësdekani (Zëvendësdrejtuesi i Njesisë Kryesore)

1. Zëvendësdekani është pjesë e personelit akademik me kohë të plotë të Fakultetit (Njesisë bazë) dhe në rast mungese ose pamundësie të përkohshme të Dekanit, ai kryen funksionet si zëvendës

- i tij, duke nënshkruar aktet në kompetencë të tij, me përjashtim të atyre që, sipas ligjit ose nga natyra e tyre, janë kompetencë ekskluzive dhe nuk mund të delegohen nga Dekani.
2. Kompetencat dhe fusha e veprimit të Zëvendësdekanit përcaktohen nga Dekani.
 3. Emërimi, pezullimi ose shkarkimi i tij bëhen sipas dispozitave të përcaktuara në Statutin e Universitetit.

Neni 18 **Drejtuesi i Njesisë bazë**

1. Drejtuesi i një Njesisë bazë është Drejtuesi i një Departamenti ose i një Qendre kërkimore - shkencore. Ai është autoriteti drejtues akademik i asaj Njesisë dhe e përfaqëson atë.
2. Drejtuesi i Njesisë bazë është personel akademik me kohë të plotë i po të njëjtës njësi dhe duhet të plotësojë kriteret e përcaktuara në Statutin e UniKZKM.
3. Ai ushtron keto funksione:
 - a. të organizojë e të kontrollojë punën mësimore - shkencore në programet e studimit që mbulon Departamenti;
 - b. të planifikojë, të organizojë e të sigurojë hartimin e planeve mësimore e programeve të lëndëve që mbulon Departamenti;
 - c. të kontrollojë zhvillimin e procesit mësimor dhe zbatimin e programeve mësimore;
 - d. të organizojë zhvillimin e konkursit të pranimit të studentëve (nëse do të ketë) në programet e studimit që mbulon Departamenti;
 - e. të informojë rregullisht Dekanin për ecurinë e procesit mësimor dhe shkencor në kurset që mbulon Departamenti;
 - f. jep mendim për çështjet lidhur me personelin e departamentit;
 - g. t'i propozojë Dekanit marrjen e masave disiplinore ndaj studentëve që shkelin dispozitat ligjore, Statutin, Rregulloren e Universitetit dhe Rregulloret e Fakultetit, dhe marrjen e masave administrative ndaj pedagogëve që nuk respektojnë kushtet e kontratës për zhvillimin e procesit mësimor;
 - h. t'i propozojë Dekanit, anëtarët dhe kryetarët e komisioneve të provimeve të pranimit, të provimeve të formimit dhe të mbrojtjes së diplomave, të komisioneve të ekuivalentimit, tezat e provimeve të pranimit, të provimeve të formimit dhe temat e projekt diplomave;
 - i. të ndjekë e të kontrollojë zhvillimin e veprimtarisë kërkimore shkencore në Departament, në përputhje me planifikimin vjetor të tij, dhe të mbajë dokumentacionin përkatës të kësaj veprimtarie të anëtarëve të Departamentit;
 - j. të organizojë vlerësimin në departament të problemeve që lidhen me procesin mësimor dhe kërkimin shkencor;
 - k. t'i propozojë Dekanit ndryshime në strukturën e Departamentit;
 - l. të programojë kualifikimin e pedagogëve të rinj;
 - m. t'i paraqesë sistematikisht Dekanit realizimin e detyrimeve kontraktuale nga personeli.
4. Emërimi ose shkarkimi i tij bëhen sipas dispozitave të përcaktuara në Statutin e Universitetit.

Neni 19 **Rektorati**

1. Rektorati është një organ kolegjal që ndihmon Rektorin në kryerjen e funksioneve të tij.
2. Përbërja dhe funksionimi i Rektoratit janë të përcaktuara në Statut.
3. Rektorati thirret çdo herë që Rektori mendon të nevojshme për diskutimet e çështjeve dhe problematikave institucionale.
4. Vendimet e Rektoratit mund të zyrtarizohen në formën e Vendimeve dhe të nënshkruhen nga Rektori.

Neni 20
Asambleja e Personelit Akademik

1. Asambleja e Personelit Akademik përbëhet nga anëtarë të personelit akademik të Njësive kryesore të UniKZKM-së të punësuar me kohë të plotë.
2. Asambleja e personelit akademik të Njesisë Kryesore (Fakulteti) drejtohet nga Drejtuesi i Njesisë Kryesore (Dekani), ndërsa Asambleja e personelit akademik të Njesisë Bazë (Departamenti) drejtohet nga Drejtuesi i Njesisë Bazë (Drejtuesi).
3. Mbledhja e Asamblesë së personelit akademik të njësisë kryesore zhvillohet kur janë të pranishëm më shumë se gjysma e anëtarëve. Asambleja mbledhet të paktën dy herë në vit.
4. Ajo ushtron, ndër të tjera, kompetencat e mëposhtme:
 - a) i propozon, Senatit Akademik, nëpërmjet përfaqesuesve të saj atje, anëtarët e Komisioneve të përhershme të Universitetit, me përjashtim të Komisionit të Disiplinës;
 - b) kryen funksione të tjera të caktuara që i janë besuar nga Senati Akademik ose në Rregulloren e Njesisë Kryesore.

Neni 21
Komisionet e përhershme

1. Komisionet e Përhershme të Universitetit dhe Komisionet e Përhershme të Njësive Kryesore përbëhen prej jo më pak se pesë anëtarësh, të cilët e mbajnë këtë detyrë për dy vjet dhe mund të rizgjidhen. Ato janë:
 - a) *Komisioni për Promovimin e Personelit Akademik;*
 - b) *Komisioni për dhënien e Gradës Shkencore “Doktor”;*
 - c) *Komisioni për Garantimin e Standarteve të Cilësisë të Universitetit dhe Programeve të Studimit*
 - d) *Komisioni për Mbarëvajtjen e Veprimtarisë Institucionale dhe Marrëdhëniet me studentët;*
 - e) *Komisioni i Disiplinës.*
2. *Komisioni për Promovimin e Personelit Akademik, Komisioni për mbarëvajtjen e veprimtarisë institucionale dhe marrëdhëniet me studentët dhe Komisioni i Disiplinës funksionojnë vetëm në nivel institucional, Komisioni për dhënien e Gradës Shkencore “Doktor” funksionon vetëm në nivel Njësie Kryesore ndërsa Komisioni për Garantimin e Standarteve të Cilësisë të Universitetit dhe Programeve të Studimit (K.G.S.C.U.P.S.) funksionon si në nivel institucional (K.G.S.C.U.P.S.U) ashtu dhe në nivel njësie kryesore (K.G.S.C.U.P.S.F.). Ky i fundit bashkëpunon ngushtë me Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë përsa i përket hartimit dhe zbatimit të politikave institucionale lidhur me sigurimin e standarteve institucionale të cilësisë. Anëtarët e Komisioneve të përhershme si në nivel institucioni ashtu dhe në nivel njësie kryesore kanë mandat 2 vjeçar, të rinovueshëm.*
3. Anëtarët e Komisioneve të përhershme të Universitetit dhe Kryetarët e tyre, me përjashtim të atyre të Nj.S.B.C., miratohen nga Senati Akademik me propozimin e Rektorit. Anëtarët e Komisioneve të përhershme të Njësive Kryesore zgjidhen nga pedagogët e secilës Njësi. Sekretari i Përgjithshëm, në rastin kur është krijuar si autoritet drejtues, mund të marrë pjesë, me ftesë të Kryetarëve përkatës, në punën e Komisioneve të Përhershme të Universitetit dhe të Njësive Bazë.
4. Në *Komisionin për Promovimin e Personelit Akademik*, bëjnë pjesë vetëm anëtarët e personelit akademik që mbajnë titullin “Profesor”, ndërsa në *Komisionin për dhënien e gradës “Doktor”* anëtarët e tij kanë titujt “Profesor” ose “Profesor i Asociuar”. Në Komisionet e tjera ka edhe një përfaqësi të studentëve.
5. *Komisioni i Disiplinës* drejtohet nga Rektori. Brenda një muaji nga raportimi për shkelje disiplinore që mund të jenë bërë nga anëtarë të komunitetit universitar, nga autoritete akademike dhe administrative monokratike, Komisioni duhet të përcaktojë sanksionet e mundshme

disiplinore, mbas marrjes së mendimit të Këshillit të Rektoratit, dhe në rastin e ankesave për shkelje të Kodit Etik, edhe të Këshillit të Etikës. Komisioni i Disiplinës ndërhyr në rastet e mbarimit të parakohshëm të mandatit të parashikuara nga neni 11, paragrafi 10, gërma c), d), e) të parashikuara në Statutin e Universitetit.

6. *Komisioni për Garantimin e Standarteve të Cilësisë të Universitetit dhe Programeve të Studimit (K.G.S.C.U.P.S.)* funksionon si në nivel institucional (*K.G.S.C.U.P.S.U*) ashtu dhe në nivel njësie kryesore (*K.G.S.C.U.P.S.F.*).

K.G.S.C.U.P.S.U. përbëhet nga 5 anëtarë: 4 anëtarë janë personel akademik me kohë të plotë (një nga secila njësi kryesore) dhe 1 anëtar është student, i caktuar nga Këshilli Studentor i Universitetit.

K.G.S.C.U.P.S.F. përbëhet nga 3 anëtarë: 2 anëtarë janë personel akademik me kohë të plotë nga njësitë bazë, të cilët vetkandidohen dhe zgjidhen nga Asambleja e personelit akademik të Fakultetit, ndërsa 1 anëtar është student, i caktuar nga Këshilli Studentor i Fakultetit.

K.G.S.C.U.P.S. ka për detyrë:

- a) të garantojë, në bashkëpunim me *Nj.S.B.C.*, implementimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të sistemit të sigurimit të cilësisë në universitet mbështetur në respektimin e standardeve shtetërore të cilësisë si dhe standardet e BE për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë;
- b) të mbështesë zhvillimin e procesit të sigurimit të cilësisë dhe standardeve akademike për të gjithë programet e studimit që ofron universiteti;
- c) pas shqyrtimit të Raportit të Brendshëm të Vlerësimit të Cilësisë të *Nj.S.B.C.* në nivel institucional ose njësie kryesore, *K.G.S.C.U.P.S.* duhet të hartojë, në përfundim të çdo viti akademik, dhe t'i përcjellë instancës drejtuese (Rektoratit, Dekanatit) dhe për dijeni *Nj.S.B.C.*, të nivelit përkatës, një relacion mbi situatën e Garantimit të Standarteve të Cilësisë gjatë vitit korent si dhe rekomandime/propozime për përmirësimin e organizimit, menaxhimit dhe funksionimit institucional dhe për mbarëvajtjen e programeve të studimit për vitin e ardhshëm akademik.

Neni 22

Dispozita për Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë

1. Për hartimin dhe zbatimin e strategjive, politikave dhe procedurave për sigurimin e brendshëm të cilësisë, në nivel institucional dhe në çdo njësi kryesore ngrihen dhe funksionojnë *Njësitë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (Nj.S.B.C.)*.
2. *Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë e Universitetit (Nj.S.B.C.U.)* përbëhet nga 7 anëtarë, nga të cilët 4 anëtarë janë personel akademik me kohë të plotë nga secila Njësi kryesore, 1 anëtar i jashtëm ekspert në fushën e sigurimit të cilësisë, i cili emerohet nga Rektori, 1 personel akademik i brendshëm i deleguar nga Rektori si dhe 1 anëtar student i caktuar nga Këshilli Studentor i Universitetit.
3. Në njësitë kryesore, *Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë e Fakultetit (Nj.S.B.C.F.)* përbëhet nga 3 (tre) anëtarë nga të cilët 2 janë përfaqësues të përzgjedhur nga personeli akademik me kohë të plotë të njësive të ndryshme bazë, si dhe 1 anëtar student, i përzgjedhur nga Këshilli Studentor i Fakultetit.
4. *Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë e Universitetit (Nj.S.B.C.U.)*
 - a) Kontrollon ecurinë e menaxhimit të Universitetit dhe të aktiviteteve të tij për arritjen e objektivave institucionale dhe monitoron zbatimin e standardeve për sigurimin e cilësisë në nivel institucional, në përputhje me Kodin e Cilësisë;
 - b) i paraqet Rektoratit, Senatit dhe *K.G.S.C.U.P.S.U.* një raport vjetor mbi mësimdhënien, kërkimin shkencor dhe shërbimet e ofruara nga Universiteti, si dhe nivelin e funksionalitetit dhe efikasitetit të arritur nga strukturat e ndryshme organizative, duke marrë parasysh gjithashtu veprimtarinë e vitit paraardhës;

- c) informon Rektoratin dhe *K.G.S.C.U.P.S.U.* mbi veprimtarinë e saj, iniciativat e ndërmarra dhe ecurinë e tyre;
 - d) shpreh vlerësime dhe i sugjeron Rektoratit e *K.G.S.C.U.P.S.U.* propozime mbi objektivat e përcaktuar dhe shkallën e arritjes së tyre, mbi akreditimin institucional dhe te programeve të studimit nga institucionet kompetente, në përputhje me legjislacionin në fuqi;
 - e) bashkëpunon me *K.G.S.C.U.P.S.U.* lidhur me hartimin dhe zbatimin e politikave institucionale të sigurimit të standarteve institucionale të cilësisë si dhe për të çështjet e tjera që kanë të bëjnë me sigurimin e cilësisë.
5. *Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë e Fakulteteve (Nj.S.B.C.F.):*
- a) Kontrollon ecurinë e menaxhimit të Fakultetit dhe të aktiviteteve të tij për arritjen e objektivave dhe monitoron zbatimin e standardeve për sigurimin e cilësisë në nivel njësie kryesore, në përputhje me Kodin e Cilësisë;
 - b) i paraqet Dekanatit, *K.G.S.C.U.P.S.F.* dhe *Nj.S.B.C.U.* një raport vjetor mbi mësimdhënien, kërkimin shkencor dhe shërbimet e ofruara nga Universiteti, si dhe nivelin e funksionalitetit dhe efikasitetit të arritur nga strukturat e ndryshme organizative, duke marrë parasysh gjithashtu veprimtarinë e vitit paraardhës;
 - c) informon Dekanatin, *K.G.S.C.U.P.S.F.* dhe *Nj.S.B.C.U.* mbi veprimtarinë e saj, iniciativat e ndërmarra dhe ecurinë e tyre;
 - d) shpreh vlerësime dhe i sugjeron Dekanatit, *K.G.S.C.U.P.S.F.* dhe *Nj.S.B.C.U.* propozime mbi objektivat e përcaktuar dhe shkallën e arritjes së tyre, mbi akreditimin institucional dhe të programeve të studimit nga institucionet kompetente, në përputhje me legjislacionin në fuqi;
 - e) bashkëpunon me *Nj.S.B.C.U.* dhe *K.G.S.C.U.P.S.F.* lidhur me hartimin dhe zbatimin e politikave institucionale të sigurimit të standarteve institucionale të cilësisë si dhe për çështjet e tjera që kanë të bëjnë me sigurimin e cilësisë.
6. Për realizimin e funksioneve të tyre dhe garantimin e standardeve të duhura të cilësisë në drejtim të një performace sa më të mirë të veprimtarisë së universitetit, *Njësitë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë* mund:
- a) të mbikëqyrin hartimin dhe shpërndarjen e pyetësorëve të ndryshëm për studentet dhe stafin akademik lidhur me programet e studimit dhe funksionimin institucional;
 - b) të kryejnë anketime për të njohur shkallën e punësimit të të diplomuarve në UniKZKM, duke vlerësuar përputhjen e programeve të studimit me nevojat e tregut;
 - c) të dokumentojnë produktin shkencor dhe realizimin e projekteve kërkimore - shkencore që përftohen nga veprimtaria e Personelit Akademik të punësuar në UniKZKM;
 - d) të bëjnë propozime dhe të shprehë mendime për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies, të kërkimit shkencor dhe të shërbimeve të tjera që u ofrohen studentëve;
 - e) të kryejnë detyra të tjera të përcaktuara me rregullore të veçanta, ose nga organet më të larta drejtuese akademike dhe administrative të vetë Universitetit, gjithnjë me synimin për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së Institucionit.

Neni 23 Dekanati

1. Dekanati është një organ kolegjal që ndihmon Drejtuesin e Njesisë kryesore (Dekanin) në kryerjen e funksioneve të tij.
2. Përbërja dhe funksionimi i tij janë të përcaktuara në Statut dhe në Rregulloren e Njesisë kryesore.
3. Dekanati thirret të paktën 3 herë në vit dhe mbledhjet e tij zhvillohen nëse janë të pranishëm shumica (50+1%) e anëtarëve të tij.

4. Ai shqyrton raportin vjetor të *N.V.I.Q F.* dhe merr masat dhe dispozitat e nevojshme për përmirësimin e cilësisë së procesit mësimor dhe kërkimit shkencor.
5. Planifikon dhe zhvillon takime me përfaqësues të Këshillit Studentor të Fakultetit me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të planifikimit dhe realizimit të procesit mësimor.

Neni 24 **Departamenti**

1. Departamenti është Njësia bazë përgjegjëse për zhvillimin e mësimdhënies dhe të punës kërkimore-shkencore të fakultetit, i cili përfshin fusha kërkimi të përafërta dhe grupon disiplinat mësimore përkatëse.
2. Përbërja dhe funksionimi i tij janë të përcaktuara në Statut dhe në Rregulloren e Njesisë kryesore.
3. Departamenti mund të organizohet në *grupe mësimore* ose në *grupe kërkimore-shkencor*, në varësi të llojit dhe misionit të njësisë.
4. Grupe të tilla mund të jenë të përhershme ose të përkohshme. Ato përbëhen nga një numër minimal prej 3 anëtarësh. Personeli akademik me kualifikimin më të lartë zgjidhet Drejtues i Grupit dhe duhet të ketë të paktën titullin shkencor “Doktor”.
5. Detaje dhe të dhëna të tjera për organizimin dhe funksionimin e grupit mësimor dhe/ose kërkimor shkencor përcaktohen në rregulloret e njësive kryesore.

Neni 25 **Qendra kërkimore – shkencore**

1. Qendra Kërkimore - shkencore e Njesisë kryesore ka statusin e Njesisë Bazë, kur plotëson standardet e përcaktuara në ligjin për arsimin e lartë.
2. Ajo është e pajisur me të njëjtat fuqi si Departamenti vetëm për aspektet specifike të përfshira në fushat e tij kërkimore.
3. Aktiviteti kërkimor karakterizon veprimtarinë e saj dhe të stafit të saj. Kjo e fundit, në një masë më të vogël, mund të përfshihet edhe në mbështetjen e aktiviteteve kërkimore të kurseve të studimit të ciklit të dytë ose të tretë, si pjesë e mbështetjes që Qendra ofron për Departamentet e Fakultetit të cilit i përket ose të Fakulteteve të tjera.
4. Qendra Kërkimore është përgjegjëse për përcaktimin dhe zhvillimin e fushës së saj kërkimore, kjo në përputhje me misionin e saj.
5. Metodatat e financimit të Qendrës Kërkimore kryhen mbi bazën e kritereve të tjera nga ato që përdoren për Departamentet.
6. Detaje të tjera për përbërjen dhe funksionimin e Qendrës përcaktohen në Rregulloren e Njesisë kryesore.

Neni 26 **Studentët dhe Organizimi i Studimeve**

1. Përsa i përket Studentëve, të gjitha dispozitat mbi statusin juridik të tyre, mbështetjen për studimet, Këshillin e studentëve, garantuesin e tyre dhe këshillimin e karrierës, janë të pasqyruara në Statut dhe në akte të tjera të veçanta.
2. Gjithashtu, përsa i përket Organizimit të Studimeve, merren në referim të gjitha dispozitatat e Statutit mbi organizimin e Programeve të Studimit (Pranimet, Transferimet, Provimet vjetore dhe të diplomës), Titujt e studimit të lëshuara (Diploma dhe Suplementi i saj) gjithashtu Dokumentacioni i Procesit Mësimor (Vërtetimet, Regjistrat, Verbalet) si dhe ruajtjen e tyre.

Neni 27

Organet dhe autoritetet administrative drejtuese

1. Organi administrativ i universitetit është Bordi i Administrimit (B.A.).
2. Autoritetet administrative janë: Administratori i UniKZKM-së dhe Administratorët e Njësive kryesore (Fakulteteve).

Neni 28

Bordi i Administrimit

1. Bordi i Administrimit është organi më i lartë drejtues administrativ i UniKZKM-së. Ai garanton përmbushjen e misionit të institucionit, duke garantuar paanshmërinë dhe mbarëvajtjen e administrimit të tij, si dhe menaxhimin e duhur ekonomik-financiar dhe pasuror.
2. Përbërja, përgjigjësitë dhe mënyrat e funksionit të Bordit të Administrimit janë të përcaktuara në ligjin e arsimit të lartë dhe në Statutin.

Neni 29

Administratori i Universitetit

1. Administratori i UniKZKM-së është përgjegjës për mirëfunksionimin financiar të institucionit. Ai ndjek zbatimin e vendimeve të Bordit të Administrimit dhe është përfaqësuesi ligjor i Universitetit për çështjet administrative dhe financiare.
2. Funksionet dhe përgjigjësitë që ushtron Administratori i Universitetit, si dhe mënyrat e emërimit dhe revokimit të tij përcaktohen në ligjin e arsimit universitar dhe në Statutin e Universitetit.

Neni 30

Administratori i Fakultetit (Njësisë kryesore)

1. Administratori i Fakultetit (Njësisë kryesore) është autoriteti më i lartë administrativ dhe është përgjegjës kryesor për mirëfunksionimin financiar dhe administrativ të vetë Fakultetit (Njësisë).
2. Funksionet dhe përgjigjësitë që ushtron Administratori i Fakultetit (Njësisë kryesore), si dhe mënyrat e emërimit dhe shkarkimit të tij përcaktohen në ligjin e arsimit universitar dhe në Statutin e Universitetit.
3. Funksioni i Administratorit të Fakultetit aktivizohet kur studentët e regjistruar në Fakultet e kalojnë pragun e 1000 njësive.

KREU IV

PERSONELI I UNIVERSITETIT

Neni 31

Personeli akademik

1. Personeli Akademik ndahet sipas kategorive të mëposhtme:
 - a) Profesorë;
 - b) Lektorë;
 - c) Asistent - lektorë;
 - d) Pedagogë të ftuar.
2. Mënyrat e shpërblimit të personelit akademik dhe mënyrat për marrjen e vitit sabbatik përcaktohen në Statut.

3. Personeli akademik i angazhuar me kohe te plote prane UniKZKM, nuk mund te punesohet si personel akademik me kohe te plote ne nje institucion tjetër te arsimit te larte, si brenda dhe jashte Vendit.

Neni 32 **Personeli ndihmës akademik**

1. Personeli ndihmës akademik ndahet në personel *ndihmës akademik me karakter mësimor* dhe *ndihmës akademik me karakter administrativ*.
2. Personeli *ndihmës akademik me karakter mësimor* ndihmon në realizimin dhe mbështetjen e veprimtarive të mësimdhënies dhe/ose të kërkimit shkencor. Ai është pjesë e njësisë bazë dhe shërben për mbështetjen e veprimtarive të kësaj të fundit. Në këtë kategori futen laborantët dhe teknikët e laboratorit, si dhe personel tjetër, sipas përcaktimeve të bëra në aktet e brendshme të institucionit.
3. Personeli *ndihmës akademik me karakter administrativ* ndihmon në realizimin dhe mbështetjen e veprimtarive të mësimdhënies dhe /ose të kërkimit shkencor dhe/ose të zhvillimit të institucionit të arsimit të lartë në nivel institucional në nivel njësie kryesore ose njësie bazë. Në këtë kategori bëjnë pjesë personeli i përcaktuar në aktet e brendshme të institucionit.
4. Në bazë të ligjeve përkatëse dhe në veçanti duke ju referuar Kodit të Punës, kontratat e punës, afatet dhe orët e punës, nivelet e pagave dhe çdo aspekt tjetër që ka të bëjë me personelin joakademik të UniKZKM, përcaktohet nga Bordi i Administrimit.
5. Akte të brendshme specifike rregullatore të UniKZKM përcaktojnë rregullat e hollësishme për punësimin, zhvillimin e marrëdhënieve dhe trajtimin ligjor dhe ekonomik të personelit ndihmes akademik.
6. Kriteret e punësimit të personelit ndihmës-akademik, me kohë të plotë, propozohen nga struktura/instanca/njësia së cilës ky personel i shërben, bazuar në nevojat e kësaj të fundit.

Neni 33 **Masat disiplinore**

1. Autoritetet drejtuese te UniKZKM marrin masa disiplinore ne rastin e moszbatimit te Statutit, Rregullores se Pergjithshme se Universitetit, te moszbatimit te vendimeve te organeve drejtuese, te mosplotesimit te detyrave te parashikuara ne kontraten e punes, te thyerjeve te disipline ne pune si dhe ne raste shkeljesh te rregullave te etikes, te parashikuara ne rregulloret perkatese.
2. Masat disiplinore jepen me shkrim. Llojet e masave disiplinore qe marrin autoritetet drejtuese te Universitetit ne rastin e shkeljes se dispozites se mesiperme jane:
 - a) "Verejtje me shkrim";
 - b) "Verejtje me paralajmerim per largim nga detyra";
 - c) "Pezullim nga detyra, deri ne marrjen e vendimit te formes se prere, per ceshtje administrative apo penale";
 - d) "Zgjidhje e kontrates se punes dhe largimi nga detyra".
3. Masa "Verejtje me shkrim" jepet per shkelje te lehta te normave rregulluese te veprimtarise se institucionit, te etikes ose te kontrates se punes.
4. Masa "Verejtje me paralajmerim per largim nga detyra" jepet per shkelje te renda, te qellimshme, ose per pakujdesi te rende te normave rregulluese te veprimtarise se institucionit, te etikes ose te kontrates se punes, si dhe ne rast se personeli ka marre dy masa "Verejtje me shkrim".
5. Masa "Pezullim nga detyra" jepet deri ne marrjen e vendimit te formes se prere, per ceshtje administrative apo penale.
6. "Zgjidhja e kontrates se punes dhe largimi nga detyra i personelit" kryhet per veprime ne

kundershtim te hapur me etiken dhe rregullat e funksionimit te institucionit ose kur personeli eshte ne kushtet e marrjes se nje mase te dyte "Verejtje me paralajmerim per largim nga detyra".

Neni 34

Procedura per dhenien e masave disiplinore

1. Per personelin akademik dhe ndihmes akademik, masat disiplinore "Verejtje me shkrim" dhe "Verejtje me paralajmerim per largim nga detyra" jepen nga Rektori, kryesisht/ose me propozim te Keshillit te Etikes, te Drejtuesit te Njesise Kryesore.
2. Per personelin akademik dhe ndihmes akademik, masa "Zgjidhja e kontrates se punes dhe largimi nga detyra" jepet nga Presidenti i Fondacionit ZKM mbi bazen e kerkeses se Rektorit dhe te autoriteteve te tjera akademike te permendura me siper.
3. Per personelin administrativ masat disiplinore jepen nga Administratori i universitetit, te zyres ose me propozim te Rektorit, Keshillit te Etikes, te Drejtuesit te Njesise Kryesore. Per Administratoret e Njesive kryesore dhe atyre baze, masat disiplinore propozohen perkatesisht nga Dekani ose Drejtuesit i Departamentit dhe miratohen nga Administratori i Institucionit, me perjashtim te mases "Zgjidhje e kontrates se punes dhe largim nga detyra", e cila jepet nga Presidenti i Fondacionit ZKM.
4. Masa disiplinore jepen pasi behen verifikimet e nevojshme per shkeljen dhe degjohet paraprakisht punonjesi.
5. Masat disiplinore jepen sipas nje procedure qe garanton te drejten per t'u informuar, per t'u degjuar, per t'u mbrojtur dhe per t'u ankuar. Vendimi per marrjen e mases disiplinore kalon ne Drejtorine e Burimeve Njerezore, e cila ia komunikon ate punemarresit.
6. Per çdo shkelje jepet vetem nje mase disiplinore. Ato, si rregull, jepen sipas nje gradualiteti, nga me e lehta deri tek largimi nga detyra, me perjashtim te rasteve ne te cilat punonjesi ka kryer shkelje te renda te ligjeve dhe akteve rregullatore.

KREU V

KËRKIMI SHKENCOR

Neni 35

Veprimtaritë e Kërkimit Shkencor

1. Mbështetur në natyrën e financimit të Kërkimit Shkencor dhe në marrëdhëniet juridike midis subjektit që zhvillon kërkimin dhe atij që e financon, veprimtaritë e kërkimit shkencor grupohen në:
 - a. *Kërkim shkencor i programuar institucional*

Në Kërkimin Shkencor të programuar institucional përfshihen veprimtaritë kërkimore të realizuara me financime që Universiteti i vë në dispozicion të strukturave të tij.

Në përputhje me nenin 5 të Statutit dhe me çdo dispozitë tjetër që lidhet me aspektet, qoftë dhe procedurale, të financimit të kërkimit shkencor, pjesëtarët e personelit akademik, të mbështetur edhe nga personeli tekniko-administrativ dhe studentët, kanë të drejtë të përdorin një pjesë të fondeve të miratuara në buxhetin e Universitetit për kërkime shkencore, sipas linjave programore të përcaktuara nga Departamenti dhe të miratuara nga Senati Akademik dhe nga Bordi i Administrimit.

Metodat dhe procedurat për realizimin e financimit institucional për kërkimin shkencor përcaktohen me akte te veçanta.

- b. *Kërkim shkencor nëpërmjet pjesëmarrjes në projekte dhe programe specifike të kerkimit shkencor*.
Kjo kategori përfshin pjesëmarrjen në programe dhe projekte kërkimore kombëtare, dypalëshe dhe ndërkombëtare.
- c. *Kërkim Shkencor për llogari të palëve të treta*
UniKZKM-ja, nëpërmjet strukturave të veta dhe kompetencave tekniko-shkencore të tyre, mund të kryejë kërkime shkencore, studime dhe konsulenza për llogari të palëve të treta ose t'i përfshijë ato në projekte të përbashkëta, në përputhje me dispozitat e Statutit dhe me kriteret procedurale të specifikuar në dispozitat e veçanta rregullatore. Ky bashkepunim rregullohet nepermjet marrëveshje *ad hoc* të nënshkruara.
- d. *Kërkim institucional nëpërmjet financimeve publike*
Në këtë kategori përfshihet Kërkimi që zhvillohet nëpërmjet financimeve të dhëna nga institucione publike që kanë si qëllim promovimin dhe mbështjen e Kërkimit Shkencor.
2. Procedurat, kriteret dhe modalitetet e perdorimit të fondeve të Kerkimit Shkencor përcaktohen në akte të tjera rregullatore.

Neni 36 **Projektet shkencore**

1. Projektet shkencore mund te realizohen:
 - a) nga vete njesia baze apo nje a me shume anetare te personelit akademik te saj;
 - b) nga njesite kryesore nepermjet bashkepunimit te njesive baze te tyre;
 - c) nga struktura te tjera kerkimore e studimore te UniKZKM;
 - d) ne bashkepunim me IAL dhe/ose me Institucione te tjera (ose njesi te tyre) vendase ose te huaja;
 - e) ne bashkepunim me organizata nderkombetare;
 - f) me organizata te ndryshme;
 - g) me shoqeri tregtare;
 - h) me kombinim te formave te mesiperme.
2. Dokumentacioni i Projektit duhet te kete te percaktuar:
 - a) drejtuesin shkencor;
 - b) stafin kerkimor (personel akademik dhe ndihmesakademik) qe do te marre pjese;
 - c) mbeshtetjen administrative, nese eshte e nevojshme;
 - d) objektin e kerkimit shkencor, veprimtarite qe do te realizohen;
 - e) shtrirjen kohore te veprimtarive dhe etapat e realizimit te tyre;
 - f) produktin shkencor qe do te realizohet dhe menyren e perdorimit te tij;
 - g) infrastrukturen kerkimore dhe bazen materiale te nevojshme qe do te perdoret per realizimin e projektit;
 - h) kostot e detajuara financiare te veprimtarive kerkimore;
 - i) burimet e financimit te projektit dhe menyren e perdorimit te fondeve;
3. Per bashkepunimet referuar rasteve te pikes 1 te ketij neni, projektit i bashkengjitet edhe marreveshja midis subjekteve pjesemarrese ku saktësohen veprimtarite qe do te kryhen nga secila pale si dhe impenjimet tjera dhe detyrimet financiare.

Neni 37 **Etika në Kërkimin Shkencor**

1. Veprimtarite e kerkimit shkencor duhet te karakterizohen nga *cilesia* e kerkimit shkencor, *ndershmeria* në përfundimet dhe rezultatet, *pergjegjshmeria* ne realizimin e tyre, *bashkepunimi* dhe *respekti reciprok* midis kolegeve pjesemarres, etj.

2. Ndalohet ndermarja e veprimeve qe konsistojne ne plagjiature, falsifikim te veprimtarive te kerkimit shkencor ne terren apo ne laborator, ne falsifikim te te dhenave te punimit shkencor, te gjetjeve dhe rezultatet perkatese te tij, etj.
3. Ndalohet ndermarja e veprimeve, qe konsistojne ne manipulim te autoresise apo denigrim te rolit te kerkuesve te tjere ne botime.
4. Ndalohet ndërmarrja e veprimeve, që konsistojnë në ribotimin e pjesëve thelbësore të botimeve të veta të mëparshme, pa cituar origjinalin.
5. Konsiderohet cenim i integritetit te kerkimit shkencor çdo sjellje ose praktike tjeter qe bie ndesh me parimet e parashtruara ne piken 1 te ketij neni.
6. Çdo person i interesuar, i cili ka pretendime per cenim te integritetit te kerkimit shkencor dhe te Kodit Etik, mund t'i drejtohet me kerkese Keshillit Etik te UniKZKM ose/dhe drejtuesit te njesise kryesore, ne te cilin ushtron detyren personeli akademik ndaj te cilit ngrihen pretendimet.
7. Per shqyrtimin e çeshtjes, drejtuesi i njesise kryesore perkatese, ngre nje Komision *ad hoc*, raporti perfundimtar i te cilit i dergohet njesise baze ku personeli akademik kryen detyren dhe Senatit Akademik. Nese shkelja konsiderohet e rende, çeshtja i percillet per kompetence Komitetit Etik.
8. Ne rastin kur konstatohet shkelje, ndiqen procedurat e percaktuara per masat disiplinore ne ligjin per arsimin e larte dhe aktet e UniKZKM.

Rektori

Prof. Leonardo Palombi

